


Mbështetja e sistemit të sigurimit të cilësisë për shërbimet sociale**Duration:** 29.11.2024 - 29.05.2027**Countries:**
North Macedonia**EU contribution:** € 1 384 500**Total budget:** € 1 384 500**Implementer:**

WYG SAVJETOVANJE, CGM Consorzio Nazionale della Cooperazione Sociale Gino Mattarelli

**Social media:**

[linkedin.com/company/107359982/admin/page-posts/published/](https://www.linkedin.com/company/107359982/admin/page-posts/published/),
[facebook.com/profile.php?id=61575916217652](https://www.facebook.com/profile.php?id=61575916217652),
[instagram.com/p/DUiUQV3CXjy/](https://www.instagram.com/p/DUiUQV3CXjy/)

Project description:

Projekti “Mbështetja e sistemit të sigurimit të cilësisë për shërbimet sociale”, përmes një qasje gjithëpërfshirëse, mbështet përmirësimin e cilësisë, efektivitetit dhe qasshmërisë ndaj shërbimeve sociale në Maqedoninë e Veriut. Qasje kjo, e fokusuar në monitorim, ndërtim të kapaciteteve dhe sigurim të cilësisë. Është strukturuar rreth tri përbërësve themelore: forcimi i Sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M dhe V), ndërtimit të kapaciteteve të Qendrave të Punës Sociale (QPS) dhe ofruesve të shërbimeve, si dhe rritjen e roleve mbikëqyrëse dhe inspektuese të institucioneve kombëtare.

Projekti do të rishikojë dhe do të përmirësojë Sistemin e Monitorimit dhe Vlerësimit ekzistues për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin kombëtar dhe Parimet e Kornizës Evropiane të Cilësisë, duke përfshirë zhvillimin e standardeve të cilësisë dhe treguesve të performancës. Gjithashtu do të ofrojë programe trajnimi të synuara për QPS-të, autoritetet vendore dhe ofruesit e shërbimeve, për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe praktikën e ofrimit të shërbimeve. Paralelisht, projekti do të forcojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë, duke përmirësuar procedurat e licencimit dhe sistemet e inspektimit, duke siguruar pajtueshmëri me standardet dhe mbikëqyrje më të mirë të shërbimeve sociale.

Përmes këtyre aktiviteteve, projekti kontribuon në një sistem mbrojtjeje sociale më efikas, më të përgjegjshëm dhe

Expected results:

- Kornizë funksionale e forcuar për zbatimin e standardeve të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë një sistem të përmirësuar të Monitorimit dhe Vlerësimi dhe kornizë performance në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
- Kapacitete të përmirësuara të palëve përkatëse të interesuara për të aplikuar metodologjitë dhe mjetet e Monitorimit dhe Vlerësimit, duke rezultuar në ofrimin, raportimin dhe planifikimin e përmirësuar të shërbimeve.
- Kapacitete të përmirësuara të mbikëqyrjes dhe inspektimit të institucioneve përgjegjëse, duke siguruar përputhshmëri më të mirë me standardet e cilësisë dhe mbikëqyrje më efektive të shërbimeve sociale.
- Efikasitet, llogaridhënie dhe cilësi më të lartë në ofrimin e shërbimeve sociale në të gjithë vendin.